

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike</b>	<b>Fakulteti i Menaxhmentit</b>
<b>Programi</b>	<b>Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia</b>
<b>Titulli i lëndës</b>	<b>Matematika për biznes</b>
<b>Niveli</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi i lëndës</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve</b>	<b>I</b>
<b>Semestri</b>	<b>I</b>
<b>Numri orëve në javë</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni</b>	<b>UShAF</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	
<b>Detajet kontaktuese</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kuptimet themelore për bashkësitë dhe veprimet me bashkësi, Bashkësia e numrave realë dhe veprimet me numra realë, Elementet e algjibrës lineare (ekuacioni i drejtëzës së buxhetit), Përcaktorët, Matricat dhe sistemet e ekuacioneve lineare, Kuptimi i funksionit dhe aplikimi i tij, Funksionet elementare dhe grafiku i tyre, Vargjet numerike dhe aplikimi i tyre, Limiti i vargut dhe i funksionit, Vazhdueshmëria e funksionit, Derivati i funksionit dhe zbatimi i tij, Elementet e matematikës financiare.
<b>Qëllimet e lëndës</b>	Qëllimi i këtij moduli është për të pajisur studentët me njohuri dhe aftësi për kuptimet themelore matematikore, elementet e matematikës financiare, kuptimin e funksionit, mënyra të dhënjes së funksionit, disa klasë funksionesh, kuptimin e matricave, derivatit, etj. Si dhe qëllimi kryesor është zbatimi i tyre në fushën e biznesit dhe ekonomisë (fushën e studimit të tyre), pra zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive të studentëve për të zgjidhur problemet konkrete të fushës ekonomike.
<b>Rezultatet e pritura të mësimnxënies</b>	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përfitoj njohuri themelore konceptuale për rëndësinë e lëndës së Matematikës në biznes,</li> <li>• Të kuptojnë elementet e algjibrës lineare në zgjidhjen e problemeve nga fusha e biznesit</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përvetësojnë elementet e matematikës financiare.</li> <li>• Të njohin konceptin e vargut dhe funksionit,</li> <li>• Te listoj llojet e funksioneve, vetitë dhe zbatimet e tyre në ekonomi.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit - konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren			
Kollokuiume - seminare			
Detyra të shtëpisë	3	10	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	1	4	4
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)</b>	Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara dhe diskutime në klasë		
<b>Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)</b>	Brenda semestrit parashihet te organizohen dy Teste me shkrim me nga 45 pike (detyra - pyetje te hapura/alternative), ose studenti ka te drejt ti nënshtrohet vetëm provimit final i cili ka 90 pikë (test me shkrim/gojë), testi përmbanë detyra dhe pyetje te hapura/alternative, Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pike nga te gjitha kriteret e vlerësimit, 10 pikë - aktiviteti dhe vijueshmëria ne ligjërata, 90 pikë - nga dy Testet me shkrime ose Provimi final,		
<b>Mjetet e konkretizimit - TI</b>	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.		

<b>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit</b>	50% Ushtrime, Detyra për pune te pavarur, 50% Ligjërata
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë</b>	1. N.L. Braha, V. Loku dhe Ilmi Hoxha, Matematika për ekonomistë, 2016, Prishtinë. 2. Ian Jacques-Mathematics,for economics and business, ninth edition, 2018
<b>Literatura shitesë</b>	1. Razim Hoxha, Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga matematika I, Prishtinë-2011
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë</b>	Nocionet themelore matematike: 1. Numrat dhe llojet e tyre Bashkësitë dhe veprimet me bashkësi
<b>Java e dytë</b>	Veprimet themelore matematikore: 1. Rregullat e veprimeve matematikore Shkalla numerike
<b>Java e tretë</b>	Algjebra: 1. Ekuacionet lineare me një të panjohur 2. Ekuacionet lineare me dy të panjohura 3. Inekuacionet Vlera absolute
<b>Java e katërt</b>	Matricat: 1. Kuptimi I matricave 2. Veprimet me matrica Aplikimi I matricave
<b>Java e pestë</b>	Përcaktorët: 1. Kuptimi i përcaktorëve (të rendit të dytë e të tretë) 2. Metoda e minorëve 3. Metoda e trekëndëshit Metoda e Kramerit
<b>Java e gjashtë</b>	Aplikimi i matricave dhe përcaktorëve: 1. Zgjidhja e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura Zgjidhja e sistemeve të ekuacioneve lineare me tri të panjohura
<b>Java e shtatë</b>	Vargjet: Kuptimi i vargjeve Llojet e vargjeve Aplikimi i tyre në biznes dhe ekonomi
<b>Java e tetë</b>	Testi i parë me shkrim,

<b>Java e nëntë</b>	Limiti i vargut
<b>Java e dhjetë</b>	Funksionet me një ndryshore: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Format e paraqitjes së funksioneve</li> <li>2. Funksionet elementare dhe grafiku i tyre.</li> </ol> Aplikimi i tyre në biznes.
<b>Java e njëmbëdhjetë</b>	Limiti i funksionit
<b>Java e dymbëdhjetë</b>	Vazhdueshmëria e funksionit
<b>Java e trembëdhjetë</b>	Derivati i funksionit dhe rregullat e derivimit Modeli makroekonomik i Keys-it
<b>Java e katërbëdhjetë</b>	Kuptimi dhe llogaritja e përqindjeve Matematika financiare: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konceptet themelore të matematikës financiare</li> <li>2. Llogaritja e investimeve</li> <li>3. Llogaritja e kamatave</li> </ol> Interesi i thjeshtë dhe i përbërë
<b>Java e pesëmbëdhjetë</b>	Testi i dytë me shkrim,
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes</b>	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	